



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 19

Prishtinë, më 5.9.2011, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

**PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT**

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Rasim Demiri, Nijazi Idrizi, Salih Morina, Sevdije Lama, Daut Haradinaj.

Munguan : Liburn Aliu, Afërdita Berisha-Shaqiri, Etem Arifi.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: zyrtari nga Ministria e MMPH, bashkëpunëtor, përfaqësues dhe vëzhgues të interesuar (KDI, OSBE), media.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. **Miratimi i rendit të ditës ,**
2. **Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 24.8.2011,**
3. **Shqyrtimi i Strategjisë për Biodiversitet,**
4. **Ndarja e grupeve punuese,**
5. **Të ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime (**Nijazi Idrizi** kundërshtoi pikën 3 për shkak se nuk është i njoftuar me këtë strategji).

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 24.8.2011

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 24.8.2011.

3. Shqyrtimi i Strategjisë për Biodiversitet

Kryetari Nait Hasani theksoi se strategjia në fjalë nga vetë propozuesi ka vërejtje financiare pasi që asnjë projekt nuk mund të financohet deri në vitin 2015, por nëse aplikohet dhe gjenden donatorët, ka mundësi të miratohet. **Ismajl Hetemaj** nga MMPH (Departamenti i Mbrojtjes së Natyrës) nuk kundërshtoi konstatimin e kryetarit përkundrazi ftoi anëtarët e komisionit që ky konstatim i kryetarit të jetë shtytëse për miratimin e këtij dokumenti ngase vetëm me ndihmën e donatorëve, për të cilët do të aplikoj MMPH, mund të zbatohet kjo strategji. **Nijazi Idrizi** tha se nuk është çështja se ai kundërshton këtë dokument por e njëjta nuk mund të shqyrtohet ngase nuk ka informacion bazik nga e cila do të mundet komisioni të bëjë pyetje ose vërejtje. **Salih Morina** ngjashëm mendoi ndërkaq **kryetari Nait Hasani** për shkak se dokumenti në fjalë është proceduar vetëm në kryesi, nxori këtë :

P Ë R F U N D I M

Shqyrtimi i Strategjisë për Biodiversitet 2011-2020 shtyhet për mbledhjen e radhës kur stafi do të përkujdeset që deri atëherë të dërgoj në mënyrë elektronike anëtarëve të komisionit dokumentin në fjalë.

4. Ndarja e Grupeve punuese për projektligjet e miratuara në parim

Kryetari i Komisionit Nait Hasani në vazhdim ftoi komisionin që në ditët në vijim grupet punuese të fillojnë shqyrtimin e projektligjeve si vijon :

Projektligji për Rregullimin e Tokës : Nijazi Idrizi, Afërdita Berisha dhe Liburn Aliu.

Stafi sugjeroi mundësisht një kryesues të caktoi takimin një ditë, tjetri kryesues në tjetrën ditë e kështu me radhë.

Projektligji për prodhimin e Duhanit : Sevdije Lama, Salih Morina dhe Etem Arifi.

Projektligji për OMGJ : Nijazi Idrizi, Sevdije Lama dhe Rasim Demiri. U sugjerua të ftohen ekspertët e duhur dhe mbështetësit e Kuvendit për të mbështetur grupin punues.

Projektligji për Shitjen e Banesave : Liburn Aliu, Afërdita Berisha dhe Etem Arifi.

Projektligji për Mbeturina : Nait Hasani, Salih Morina, Daut Haradinaj, Liburn Aliu, Sevdije Lama dhe Blerim Vela.

Monitorimi i Ligjit për Tokën Bujqësore : u vendos të mbahet dëgjimi publik më 14.9.2011 në orën 11,00, pastaj në komision të ftohet ministri i bujqësisë në mbledhjen e radhës.

Monitorimi i Ligjit për VNM : të hartohet plani i veprimit për monitorim.

Projektligji për fshatin Hoçë e Madhe : Grupi punues : Liburn Aliu (kryesues), Daut Haradinaj, Salih Morina, Sevdije Lama, Nait Hasani, Etem Arifi. **Daut Haradinaj** kërkoi seriozitet dhe precizitet në punën me këtë projektligj duke nënshkruar secili anëtarë i grupit qëndrimin e vet. **Kryetari Nait Hasani** sqaroi se janë rregullat e caktuara si punon komisioni dhe nënkomisioni me projektligje, mirëpo **z. Haradinaj** e propozoi këtë ngase në mbledhjet plenare ndonjëherë ndodhin reagimet ndryshe nga ato që miratohen në komisione.

5. Të ndryshme

Kryetari Nait Hasani për këtë pikë ftoi dy anëtarët e Bordit të Mjedisit për të sqaruar brengën e tyre të cilën e kanë shprehë përmes publikimit të letrës në media nga ky Bord. **Sylejman Berisha-kryesues** dhe **Behxhet Mustafa** njoftuan komisionin për pozitën e vështirë të Bordit për shkak të mosfunksionimit të hallkës së komunikimit me MMPH përkatësisht me ministrin që udhëheq këtë ministri si dhe çështjes financiare që do të mundësonte funksionimin e Bordit. Ata theksuan se ky bord është dashur të këshilloj Qeverinë dhe Kuvendin për çështje mjedisore qysh nga viti 2003 kur është miratuar Ligji për Mjedisin, mirëpo askush nuk ka qarë kokën për këtë derisa ndërkombëtarët (z. Nikolas nga BE) kanë ndërhy dhe kanë bërë presion, në këtë mënyrë ky Bord është themeluar më në fund më 2010. Komisioni parlamentar nga mandati i kaluar ka

bërë mjaft presion, poashtu edhe kryetari i komisionit nga ky mandat mirëpo takimet me ministrin e MMPH kanë qenë të pamundura ngase arsyetimet kanë qenë : ministri nuk ka kohë. Është intervenuar edhe përmes sekretarit dhe zëvendës ministrit por kot sepse ata kanë thënë që ky punë është në dorë të ministrit. Ata shprehën brengën përfundimtare sepse mjedisi në Kosovë po pëson vazhdimisht ndërsa Bordi Mjedisor nuk po mund të funksionoj përkundër shkresave alarmuese nëpër media. Ndërkombëtarët nga BE kanë premtuar 600 milion euro ndihmë për vendet kandiduese por asnjë kërkesë nuk figuron aty ku duhet, ndaj Bordi vendosi që të drejtohet këtij komisioni duke shpresuar në rezultat pozitiv.

Nait Hasani falënderoi dhe fillimisht tha se ky komision nuk është ai që ballafaqon Bordin me ministrin e MMPH por megjithatë premtoi se ky komision do të ftoj ministrin e MMPH lidhur me këto brenga rreth funksionimit të Bordit Mjedisor. Falënderuan edhe dy anëtarët prezent të Bordit Mjedisor.

Në fund kryetari ftoi komisionin në festën e rrushit në Rahovec më 7 shtator, duke u nisur në orën 10,00 nga Kuvendi.

Mbledhja përfundoi në orën 12,00.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,

Nait Hasani